



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:268846
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05255344

C.nr. 586/22

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore profesionale Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: N. Z. nga fshati K..., Komuna Pejë, N. G.-Z. nga fshati Ç... , Komuna Klinë, E. Z. , nga fshati K..., Komuna Pejë të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor – nëna N. G. Z. , e të cilët i përfaqëson me autorizim Avokatura ‘‘K... & P...’’ Sh.p.k. P... , me avokatë Xh. K. , I. N. dhe E. B.-Bashkëpunëtore, Rr. ‘...’’, nr. ... U..., kundër të paditurës: B. K. e S. , me seli në P... , e përfaqësuar nga V. V. dhe L. S. , me autorizim si në shkresat e lëndës, me bazë juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit: 8,840.00€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur me datë 15.01.2024, në prezencë të autorizuarave të palëve ndërgjyqëse, me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësve, N. Z. , N. G.-Z. , dhe E. Z.

II.DETYROHET e paditura B. K. e S. , me seli në P... , që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksidentin e trafikut të datës 18.06.2022, t’ua paguaj shumën e përgjithshme prej 8,840.00 €, dhe atë si në vijim:

II/a. Paditësit N. Z. shumën prej 2,680.00 €

në emër të demit jo material:

-për dhimbjet fizike shumën prej 1,500.00€;

- për frikën e përjetuar shumën prej 1,000.00€.

gjithsej shumën 2,500.00€

Në emër të dëmit material:

- për ndihmën e personit të tretë shumën prej 60.00€;
- për ushqim të përforcuar shumën prej 120.00€;

gjithsej shumën prej 180.00€

II/b. Paditëses N. Z. shumën prej 2,880.00 €

në emër të dëmit jo material:

- për dhimbjet fizike shumën prej 1.500.00€;
- për frikën e përjetuar shumën prej 1,200.00 €.

gjithsej shumën 2,700.00€

Në emër të dëmit material:

- për ndihmën e personit të tretë shumën prej 60.00€;
- për ushqim të përforcuar shumën prej 120.00€;

gjithsej shumën 180.00€

II/c. Paditësit E. Z. shumën prej 2,980.00 €

në emër të dëmit jo material:

- për dhimbjet fizike shumën prej 1,500.00€;
- për frikën e përjetuar shumën prej 1,300.00€.

gjithsej shumën 2,800.00€

Në emër të dëmit material:

- për ndihmën e personit të tretë shumën prej 60.00€;
- për ushqim të përforcuar shumën prej 120.00€;

gjithsej shumën 180.00€

me kamatë në lartësi prej 8% e cila në shumat e aprovuara në emër të dëmit jo material në lartësi prej 8,000.00€ do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit 26.01.2024 e deri në pagesën e tërësishme, ndërsa në shumat e aprovuar në emër të dëmit material në lartësi prej 540.00€ do të llogaritet nga data 16.12.2022 kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura B. K. e S. , me seli në P... , që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,656.80€, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET, pjesa e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së aprovuar si në pikën I të këtij aktgjykimi dhe atë: për paditësin N. Z. , për dhimbjet fizike shumën prej 500.00€; për frikën e përjetuar shumën prej 1,000.00€, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 440.00€; për ushqim të përforcuar shumën prej 380.00€; Për paditësen N. Z. , për dhimbjet fizike shumën prej 500.00€; për frikën e përjetuar shumën prej 800.00€, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 440.00€; për ushqim të përforcuar shumën prej 380.00€; Për paditësin E. Z. , për dhimbjet fizike shumën prej 500.00€; për frikën e përjetuar shumën prej 700.00€. për ndihmën e personit të tretë shumën prej 440.00€; për ushqim të përforcuar shumën prej 380.00€; ndërsa në tërësi refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve për rehabilitim klimaterik për paditësin N. Z. në shumën prej 500.00 €, për paditësen N. Z. në shumën prej 500.00 €, dhe paditësin Eduard Zogu në shumën prej 500.00 €, si E PABAZUAR.

Arsyetim

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi me datë 16.12.2022, kundër të paditurës B. K. e S. , me seli në P... , me bazë juridike: kompensim dëmi, Në padi ka theksuar më dt.18.06.2022 në K... , tek N... M..., është shkaktuar aksident, në të cilin lëndime trupore kanë pësuar paditësit, i cili aksident ka ndodhur si pasojnë e ngasësit të automjetit të pasiguruar i cili nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit rrugor.

I autorizuari i paditësve, gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, në bazë të raportit të aksidentit konstatohet se paditësi N. Z. në kohën e aksidentit ka qenë drejtues i automjetit 'B' kurse paditësit N. Z. dhe E. Z. kanë qenë pasagjer, në pjesën e raportit të aksidentit të përshkrimi i ngjarjes është shënuar se pala ka sjell raportet mjekësore për E. Z. , të njëjtit nuk kanë lëshuar raport të zgjeruar lidhur me emrat e të lënduarve pasi që nga përgjigja në padi kontestohet pjesëmarrja e paditësve në aksident, në bazë të ekspertizës janë konstatuar lëndimet e paditësve dhe lidhja kauzale e këtyre lëndimeve në aksidentin e datës 18.06.2022, andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësve që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, shumat si në parashtrësën për precizim e padisë e datës 15.01.2024 me kamatë ligjore 12% dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të specifikuara si në parashtrësën për precizim dhe gjatë shqyrtimit kryesor sa i përket taksës shtesë.

Përfaqësuesja e të paditurës në përgjigjen në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: nuk e kundërshton bazën juridike sa i përket rrjedhës së aksidentit por e kundërshton kërkesën e paditësve për kompensimin e dëmit jo material dhe material. E paditura

si në procedurën administrative ashtu edhe gjatë seancave gjyqësore ka kërkuar plotësimin, respektivisht dëshmi të lëshuar nga policia se paditësit N. dhe N. Z. kanë qenë pjesëmarrës në aksidentin me datë 18.06.2022, dhe për kundër kësaj kërkesë ashtu siç e parasheh edhe neni 24 i LSDA-së, nuk ka pranuar ndonjë dëshmi lidhur me atë se paditësit e lartcekur kanë qenë pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit dhe të njëjtit kanë pësuar lëndime. Referuar raportit policor përmendet se paditësi E. Z. ka raporte mjekësore e ndërsa bazuar në raportin mjekësor të datës 18.06.2022, mjekët kanë konstatuar se i njëjti është pa lëndime evidente pra nuk ka lëndime trupore si pasojë e këtij aksidenti. Meqenëse sipas nenit 319 par. 1 të LPK-së, barra e provës bie mbi atë i cili pretendon se ka të drejtë për realizimin e kërkesës dhe i njëjti duhet ta provoi një gjë të tillë me prova materiale dhe duke pasur parasysh se deri me tani nuk ka sjellë ndonjë dëshmi për pjesëmarrjen e a paditësve në këtë aksident, andaj e paditura i propozon gjykatës që në mungesë të një prove e cila është relevante në këtë rast padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar në mungesë të provave materiale, ndërsa për shpenzimet e procedurës i ka propozuar gjykatës që të aplikoi dispozitën ligjore 452 par, 1 të LPK-së.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: ekspertiza mjekësore e datës 01.12.2023, nga ekspertet DR. Xh. S. -Ortoped dhe Dr. J. Z. - Psikiatër, ujdia jashtëgjyqësore e datës 26.10.2022 në mes të B.K.S. dhe N. Z. (pronare e automjetit), raporti i aksidentit nr. 2022DE276, i datës 18.06.2022, kërkesë për kompensimin e dëmit e datës 20.09.2022, B.K.S. –N. Z. , N. Z. dhe E. Z. përmes përfaqësueses N. Z. me listën e regjistrimit, certifikata e lindjes për E. Z. e datës 26.06.2019, raporti nga Spitali i Përgjithshëm Pejë-Emergjencia, Nr. Prot.12116 i datës 19.06.2022 në emër të E. Z. , udhëzim për konsultim nr. 016602 i datës 19.06.2022 në emër të E. Z. , raport nga konsulta Nr. Kod. 80114036 i datës 18.06.2022 në emër të E. Z. , raport nga konsulta Nr. Kod. 80114036 i datës 19.06.2022 në emër të N. Z. , raport nga konsulta Nr. Kod. 80114036 i datës 19.06.2022 në emër të N. Z. , kontratë për shitblerjen e automjetit LRP, nr. 6838/2021 i datës 25.08.2021, librezë e automjetit dhe certifikata e lidhur me të dhënat e automjetit në emër të N. Z. .

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë rast nuk ishte kontestuese baza juridike sa i përket rrjedhës së aksidentit por kontestuese është kërkesa e paditësve për kompensimin e dëmit jo material dhe material sa i përket lartësisë.

Nga raporti i aksidentit nr. 2022DE276, i datës 18.06.2022, gjykata konstatoi se aksidenti kishte ndodhur në ditën e përshkruar si në kërkesëpadi dhe se shkaktari i aksidentit kishte mbulesë të sigurimit tek Kompania e Sigurimeve "S..." mirëpo i ka skaduar me datë 14.08.2021, ku në ditën kritike duke dalur nga parkingu i N... M..., në lëvizje mbrapa nga pakujdesia kishte goditur automjetin e paditëses së lartcekur duke shkaktuar aksident trafiku sipas të cilit drejtuesi i automjetit B ka sjellë dokumentacionin mjekësor për djalin e tij E. Z. .

Nga kërkesa për kompensimin e dëmit e datës 20.09.2022, B.K.S-N. Z. , N. Z. dhe E. Z. përmes përfaqësueses N. Z. me listën e regjistrimit gjykata gjeti se paditësi kanë parashtruar kërkesë tek B... K... e S... , me seli në P... , për kompensimin e dëmit për lëndimet trupore dhe dëmin material në automjet.

Nga certifikata e lindjes për E. Z. e datës 26.06.2019, gjykata gjeti se paditësi E. Z. është i lindur me 22.12.2008 i cili është ende nën moshën madhore (i mitur), të cilin e përfaqëson nëna e tij N. Z. .

Nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 26.10.2022 në mes të B.K.S. dhe N. Z. (pronare e automjetit) gjykata gjeti se në mes paditëses N. Z. dhe të paditurës është arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për dëmin material- në automjet të shkaktuara në aksidentin e datës 18.06.2022.

Nga kontrata për shitblerjen e automjetit LRP, nr. 6838/2021 i datës 25.08.2021, librezja e automjetit dhe certifikata e lidhur me të dhënat e automjetit në emër të N. Z. , gjykata gjeti se paditësja N. Z. është pronare e automjetit M..., Tipi a 140, i cili automjet ka pësuar dëmtime materiale në aksidentin e lartcekur.

Nga i tërë dokumentacioni mjekësor që e ka administruar gjykata për këtë çështje juridike, konstaton se paditësit kanë qenë të detyruar të marrin shërbime mjekësore, për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 18.06.2022.

Me qëllim të vërtetimit të lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit, natyrën dhe pasojat e këtyre lëndimeve, gjykata me propozim të palës paditëse, ka nxjerr provën përmes ekspertizës mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë.

Gjykata nga mendimet e dhënë me shkrim të ekspertëve mjekësor Xh. S. - ortoped - traumatolog dhe J. Z. - psikiatrër, duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditëseve, ka vërtetuar si në vijim, se:

Paditësi N. Z. , si pasojë e aksidentit, ka pësuar lëndime të lehta trupore-pa pasoja dhe atë përdredhje të unazave të belit. Më tej, sipas këtij mendimi Gjykata vërtetoi dhimbjet fizike që ka pësuar paditësi, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. Ekziston lidhja kauzale e raporteve mjekësore dhe aksidentit, janë brenda 24 orëve. Paditësi ka përjetuar frikë primare (frika primare është shkurtër dhe zgjatë disa sekonda 2-3 sek), frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3-7 ditë. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 10-15 ditë. Më tej, sipas këtij mendimi Gjykata vërtetoi frikën që ka përjetuar i njëjti kohëzgjatjen dhe manifestimin e saj. Po ashtu ka konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar.

Paditësja N. Z. , si pasojë e aksidentit, paditësja ka pësuar lëndime të lehta trupore-pa pasoja dhe atë ndrydhje të krahut të djathtë e shoqëruar me përdredhje të qafës. Më tej, sipas këtij mendimi Gjykata vërtetoi dhimbjet fizike që ka pësuar paditësja, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. ekziston lidhja kauzale e raporteve mjekësore në emër të N. Z. dhe aksidentit, janë brenda 24 orëve. Paditësja ka përjetuar frika primare e intensitetit të lartë në momentin e aksidentit, e përjetuar në formë të frikës primare, e cila ka zgjatur 2-3 sekonda. Frika sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjatur 5-7 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm, e cila ka zgjatur ka zgjatur 15-20 ditë. Më tej, sipas këtij mendimi Gjykata vërtetoi frikën që ka përjetuar i njëjta dhe kohëzgjatjen dhe manifestimin e saj. Po ashtu ka konstatuar se paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar.

Paditësi E. Z. , si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të lehta trupore-pa pasoja dhe atë ndrydhje e kokës dhe marramendje, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Më tej, sipas këtij mendimi Gjykata vërtetoi dhimbjet fizike që ka pësuar paditësi, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. Paditësi ka përjetuar frikë primare (frika primare është shkurtër dhe zgjatë disa sekonda 2-3 sek), frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 7-10 ditë. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 15-25. ditë. Më tej, sipas këtij mendimi Gjykata vërtetoi frikën që ka përjetuar i njëjti dhe kohëzgjatjen dhe manifestimin e saj. Po ashtu ka konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar.

Gjykata ua fali besimin e plotë ekspertizave të lartpërmendura, ngase të njëjtat përmbajnë elemente të nevojshme, të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje juridike kontestimore.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Me nenin 136 par.1 të LMD-së parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij: kurse me nenin 159 i LMD-së, par.1 thotë: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”*. Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Sipas nenit 169 paragrafi 1 të LMD-së: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.”* Ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit nen parasheh se: *“Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme. “Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se: “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*”.

a) *Për paditësin N. Z.*

Për dhimbjet fizike Gjykata ka caktuar shpërblim në shumë prej 1,500.00€, duke e pranuar pjesërisht kërkesën e paditësit për këtë formë të dëmit jo material, të cilën shumë e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve të marra dhe mënyrën e manifestimi të tyre, dhe kohëzgjatjes së dhimbjeve fizike si pasojë e lëndimeve, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 10 min., të intensitetit të rëndë 24 orë (kohë pas kohe deri në marrje të terapisë kundër dhimbjes), intensitetit mesatar 10 ditë (kohë e nevojshme për rikuperimin fillestar e boshtit kurrizor të belit nga ky lëndim) dhe intensitetit të

ulët ku i njëjti ankon dhimbje në pjesën e poshtme të belit të cilat janë më të shprehura në mbrëmje, në sforcime fizike dhe ndryshime klimatike.

Për frikën Gjykata ka caktuar shpërblimin për paditësin N. Z. , 1,000.00€, duke e pranuar kështu pjesërisht kërkesën për këtë formë të dëmit jo material, me c ‘rast Gjykata pati parasysh mendimin e ekspertit mjekësor sipas të cilit ka përjetuar frikë primare (frika primare është shkurtër dhe zgjatë disa sekonda 2-3 sek), frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3-7 ditë, që është manifestuar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit të përjetuar, një ndjenjë subjektive të mpirjes, shkëputjes apo mungesës së reagimit emocional, gjithashtu të pranishme kanë qenë vështërsit me gjumë, hipervigjiliteti dhe reagimi i tepruar emocional. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 10-15 ditë e manifestuar me rikujtime rekurente (të përsëritura) dhe intrusive (të imponuara) të ngjarjes duke përfshirë pamjet, mendime apo perceptime. Një shqetësim intensiv psikologjik pas ekspozimit ndaj faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të cilët simbolizojnë apo ngjajnë me ndonjë aspekt të ngjarjes traumatike dhe ka kaluar në frikë të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje në periudhë kohore prej me shumë se 2 muaj deri në disa vite pas aksidentit, kjo gjendje është gjithashtu është manifestuar me vështirësi me fillimin apo vazhdimin e gjumit, iritabiliteti apo shpërthimet e zemërimit, vështirësi në përqendrim dhe ulja e pragut të reagimit.

b) Për paditësen N. Z.

Për dhimbjet fizike Gjykata ka caktuar shpërblim në shumë prej 1,500.00€, duke e pranuar pjesërisht kërkesën e paditëses për këtë formë të dëmit jo material, të cilën shumë e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve të marra dhe mënyrën e manifestimi të tyre, dhe kohëzgjatjes së dhimbjeve fizike si pasojë e lëndimeve, pasi paditësja ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 10 min., të intensitetit të rëndë 24 orë (kohë pas kohe deri në marrje të terapisë kundër dhimbjes), intensitetit mesatar 10 ditë (kohë e nevojshme për rikuperimin fillestar të boshtit kurrizor dhe qafës), dhe intensitetit të ulët, ku paditësja vazhdimisht ankon për dhimbje të qafës dhe krahut të djathtë të shprehura në sforcime fizike dhe ndryshime klimatike si dhe ankon edhe ma pagjumësi.

Për frikën Gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,200.00€, duke e pranuar kështu pjesërisht kërkesën për këtë formë të dëmit jo material, me c' rast Gjykata pati parasysh mendimin e ekspertit mjekësor sipas të cilit ka ekzistuar frika primare e intensitetit të lartë në momentin e aksidentit, e përjetuar në formë të frikës primare, e cila ka zgjatur 2-3 sekonda. Frika sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjatur 5-7 ditë, që është manifestuar me gjendje të reagimi akut ndaj stresit të përjetuar, një ndjenjë subjektive të mpirjes, shkëputjes apo mungesës së reagimit emocional. Gjithashtu ka qenë vështërsit me gjumë, hipervigjiliteti dhe reagimi i tepruar emocional. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm, e cila ka zgjatur ka zgjatur 15-20 ditë, e cila është manifestuar me rikujtime rekurente (të përsëritura) dhe intrusive (të imponuara) të ngjarjes duke përfshirë pamjet, mendime apo perceptime. Ëndrra rekurente shqetësuese rreth ngjarjes, sjellja apo ndjenja sikur ngjarja traumatike të ishte përsëritur. Kjo ka kaluar në frikë të intensitetit të ulët, që ka zgjatur në periudhë kohore prej me shumë se 2 muaj deri disa vite pas aksidentit, e shoqëruar fillimisht me brengen e vazhdueshme për të ardhmen shëndetësore të tij duke marrë parasysh pasojat e lëndimit trupor, kjo gjendje është gjithashtu është manifestuar me vështirësi me fillimin apo vazhdimin e gjumit, iritabiliteti apo shpërthimet e zemërimit, vështirësi në përqendrim dhe ulja e pragut të reagimit.

c)Për paditësin E. Z.

Për dhimbjet fizike Gjykata ka caktuar shpërblim në shumë prej 1,500.00€ , duke e pranuar pjesërisht kërkesën e paditësit për këtë formë të dëmit jomaterial, të cilën shumë e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 10 min., të intensitetit të rëndë 24 orë (kohë pas kohe deri në marrje të terapisë kundër dhimbjes), intensitetit mesatar 10 ditë (kohë e nevojshme për rikuperimin fillestar e boshtit kurrizor të qafës nga ky lëndim) dhe intensiteti të ulët ku i njëjti ankon në dhimbje të qafës për rreth një muaji pas aksidentit.

Për frikën Gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë, 1,300.00€, duke e pranuar kështu pjesërisht kërkesën për këtë formë të dëmit jomaterial, me c' rast Gjykata pati parasysh mendimin e ekspertit mjekësor sipas të cilit paditësi, ka përjetuar frikë primare (frika primare është shkurtër dhe zgjatë disa sekonda 2-3 sek), frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 7-10 ditë, që është manifestuar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit të përjetuar, një ndjenjë subjektive të mpirjes, shkëputjes apo mungesës së reagimit emocional, sjellje regressive

manifestuar me urinim i pavullnetshëm, parehati dhe shpërthim në vaj pa ndonjë arsye gjithashtu pranishme kanë qenë vështërsit me gjumë, hipervigjiliteti dhe reagimi i tepruar emocional. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 15-25 ditë e manifestuar me rikujtime rekurente (të përsëritura) dhe intrusive (të imponuara) të ngjarjes duke përfshirë pamjet, mendime apo perceptime. Ëndrra rekurente shqetësuese rreth ngjarjes, sjellja apo ndjeja sikur ngjarja traumatike të ishte duke u përsëritur. Një shqetësim intensiv psikologjik pas ekspozimit ndaj faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të cilët simbolizojnë apo ngjajnë me ndonjë aspekt të ngjarjes traumatike dhe ka kaluar në frikë të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje në periudhë kohore prej me shumë se 2 muaj deri në disa vite pas aksidentit e shoqëruar fillimisht me brengen e vazhdueshme për të ardhmen shëndetësore të tij duke marrë parasysh pasojat e lëndimit trupor, një rënie e theksuar e interesimit apo pjesëmarrjes në aktivitete të rëndësishëm, ndjenja e një të ardhme të errët, ku personi nuk e pret që të ketë karrierë apo jetëgjatësi normale. Kjo gjendje është gjithashtu është manifestuar me vështirësi me fillimin apo vazhdimin e gjumit, iritabiliteti apo shpërthimet e zemërimit, vështirësi në përqendrim dhe ulja e pragut të reagimit.

Lidhur me kërkesat e paditëseve për kompensimin e dëmit material, Gjykata ka vendosur si në vijim:

Gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesat e paditëseve N. Z. , N. Z. dhe E. Z. lidhur me kompensimin në emër të përkujdesjes dhe ndihmës së personit tjetër secilit në shumë prej 60.00 Euro, pasi paditësit N. Z. sipas mendimit të ekspertëve mjekësor ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për 10 ditë, paditësja N. Z. ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për 10 ditë, dhe paditësi E. Z. ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për 10 ditë.

Gjykata i ka aprovuar pjesërisht kërkesat e paditësve N. Z. , N. Z. dhe E. Z. për kompensimin e dëmit në emër të ushqimit të përforcuar, dhe atë secilit në shumë prej 120.00 Euro, pasi paditësit N. Z. sipas mendimit të ekspertëve mjekësor, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditësh, paditësja N. Z. ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditësh dhe paditësi E. Z. ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për 20 ditë.

Gjykata konsideron se shumtat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfakcion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuarat të paditëseve në aksidentin e komunikacionit, lëndimet dhe pasojat, moshën e paditësve si dhe duke marrë

parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitat e LMD-së, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deritanishme të Gjykatave të Kosovës.

Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj të aprovuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi i vlerëson se janë adekuate dhe se mund të caktohen edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material, gjegjësisht për dhimbjet fizike dhe frikën, për paditësit, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumave të gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirat e shkelura dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. E njëjta poashtu gjeti se shumat e kërkuar për këto kategori të dëmit janë të larta dhe në kundërshtim me natyrën e lëndimeve, pasojat e lëndimeve dhe provat e administruara (mendimet e ekspertëve mjekësor).

Për pjesën e refuzuar për dëmin material sa i përket përkujdesjes dhe ndihmës së personit, si dhe ushqimit të përforcuar, gjykata vendosi si në dispozitiv, kjo pasi që në vlerësimin e gjykatës, vlerat për këto shpenzime janë të bazuara në praktikën gjyqësore për këtë lloj të kompensimit, përputhen në kohëzgjatjen e nevojës për ushqim të përforcuar, dhe për kujdes të personit të tretë, në rastin konkret gjykata konsideron se paditësve kujdesin dhe ndihmën ia kanë ofruar anëtarët e familjes.

Gjykata i ka refuzuar në tërësi kërkesat e paditëseve për kompensimin e shpenzimeve për rehabilitim, për shkak se paditësit nuk kanë parashtruar ndonjë provë përkatësisht faturë për të arsyetuar shpenzimet e tyre lidhur me këto lloj kërkesa.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e ë përfaqësuesit të paditurës, se nuk janë ofruar dëshmi se paditësi N. dhe N. Z. kanë qenë pjesëmarrës në aksident dhe se sipas raporteve mjekësore paditësi E. Z. ka qenë pa lëndime, por të njëjta i vlerësoi të pabazuara pasi që nga ekspertiza nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë vërtetohet se ekziston lidhja kauzale në mes raporteve mjekësore dhe aksidentit që janë brenda 24 orëve sa i përket Paditëseve N. dhe N. Z. , dhe konstatohen lëndimet dhe pasojat e tyre. E po ashtu konstatohen edhe llojet dhe pasojat e lëndimeve për të paditësin E. Z.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 të LMD-së, e cila në shumat e aprovuar në emër të dëmit jo material do të llogaritet nga data kur është marr ky aktgjykim e deri në pagesën definitive, ndërsa në shumat e aprovuar në emër të dëmit material do të llogaritet nga data kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t'i bart shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452.2 të LPK në shumën e përgjithshme prej 1,656.80€ dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 416.00€, për taksë për padi shumën prej 100.00€, për pjesëmarrje në seanca gjyqësore të mbajtura shumën 540.80€ (2x270.40 euro), dhe për ekspertiza mjekësore shumën prej 600.00€, ndërkaq gjykata refuzoi pjesën tjetër të shpenzimeve sa i përket përfaqësimit bazuar në nenin 452.5 të LPK-së dhe shpenzimet për precizim të padisë duke u bazuar në nenin 30 .1 dhe 253 pika d të LPK-së, për arsye se paditësit kanë qenë të obliguar që në rastin e parë ta paraqesin vlerën e objektit të kontestit, ndërsa e paditura nuk i ka dhënë shkas këtij precizimi.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 586/22 i dt. 26.01.2024

Gj y q t a r j a
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate